



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:128894
Datë: 27.08.2024
Numri i dokumentit: 06092466

C.nr.1141/18

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, në kontestin e paditësit N.P. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson av.K.M. nga Prizreni sipas projektit të Ndhimes Juridike Falas, kundër të paditurit E.A. nga Prizreni, shkak të kthimit të borgjit, vlera e kontestit 8.000 € më datën 27.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET SI E PA LEJUSHME padia e paditësit në këtë çështje juridike kontestimore.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.P. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson av.K.M. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit E.A. nga Prizreni, shkak të kthimit të borgjit, vlera e kontestit 8.000 €.

Gjykata lidhur më këtë çështje juridike ka caktuar disa herë seancat përgatitore, por ato nuk janë mbajtur për shkak se i padituri nuk është thirrur në mënyrë të rregullt për shkak se është vërtetuar fakti se nuk gjendet në adresën e dhënë si në padi respektivisht ka ndërruar vendbanimin. Gjykata me qëllim të zhvillimit të procedurës më aktvendimin C.nr.1141/18 të datës 11.10.2023, e ka obliguar paditësin që të depozitoj në arkën e kësaj gjykate shumën prej 405 € në afat prej 7 ditësh, me qëllim të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin E.A. nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Numri i lëndës: 2019:128894

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06092466

Duke marr parasysh faktin se paditësi nuk ka bërë fare deponimin e të hollave për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 391 par.1 (g) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

-Departamenti i përgjithshëm-

C.nr.1141/18, datë 27.08.2024

Gjyqtari,

Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.